**Jozef Shvejk** is at **Bashkia e Tiranës.**

8 August 2017 · Tirana ·

Sot u takova me lali Erin, i kerkova si armik qe te sulmonte kunatin. Ndoshta Luli reagon me nje status ne facebook!




Bashkia e Tiranës

Government building · Tirana

3,553 check-ins

Save

Like Comment Share



**Jozef Shvejk**

June 28, 2017 ·

Ne Tirane PD ka marre 20 mije vota me pak se ne 2013, kete diversion po e them qe neser kur PD te marre 50 mije vota me pak se ne 2017 te ngrininpak me shume Lulin, kur ne 2025 te merret 60 mije vota me pak se ne 2017 te ngrini kedo tjeter vec Lulit. Mos u habisni se PD do ta genjeje Rama se do vije heres tjeter ne pushtet! Gjithsesi ben vaki dhe del llafi im por Lulzim Bashen mos e luani se ai ne krye te PD-se mundeson lindjen e diellit perdite!

Jozef Shvejk
February 22, 2018 ·

Nga shtatori deri me tani opozites i kane ardhur ne dore me se paku tre raste flagrante mbi te cilat ajo mund te ngrinte kauza politike qe mund te dergonin vendin ne nje destabilizim politik, qe mund te shkundnin kete sistem te ngritur nga Nano dhe perfeksionuar ne absolut nga Rama. Fatkeqesisht per opozitaret (por jo per opoziten kuvendore) keto shanse nuk u shfrytezuan aspak nga opozita dhe kryetari i saj.

Shanset ne forme te permbledhur jane keto; Se pari deklarata e ministrit te brendshem italian per drogen nga pallati kongreseve, se dyti mosarrestimi dhe mbrojtja politike qe iu be Saimir Tahirit dhe se treti; emerimi ne kundershtim me kushtetuten e PPP-se Arta Marku. Opozita duket se keto tre ceshtje i zbrazi ne nje xhiro te se shtunes ne daten 27 janar 2018. Ne ate proteste, qe vetem e tille nuk ishte, kryetari i opozites deshmoi edhe nje here se sa pa thelb e pa mesazh eshte vizioni i tij opozitar.
Do pyesni me te drejte se cfare mund te beje opozita kur nderkombetaret heshtin ndersa popullit nuk ia ndjen?

Djegia e mandatave eshte pergjigja ime! Vetem mandatet e djegura dhe sfida e hapur ndaj nderkombetareve hipokrite edhe te shitur do te mund te trondiste kancelarite dhe zyrat e Europes perendimore. Vetem djegia e mandateve do te sillte opoziten ne krahun e qytetareve qe nga ekranet e televizorit shohin nje kryetar opozite jashte orbite, me te cilin perqeshet tanime jo vetem nje kryeminister por edhe nje mazhorance e tere. Heshtja e shqiptareve, aq me teper e demokrateve, vjen sepse ato nuk kane me besim tek opozita e republikes se re.

Duke djegur mandatet opozita i jep mundesi Rames te arrestoje kedo opozitar qe ai mendon se eshte i kompromentuar. Tanime, deputetet e opozites do te jene pa imunitet dhe PPP Marku nuk do te kete nevoje per te shkuar tek byroja Rucci per mandatet. Kesisoj, pa nje opozite te zgjedhur nga shqiptaret por me nje opozite kukull te inskenuar nga Rama dhe cifti ambasadoreve kjo qeveri dhe ky sistem do te jete i deligjitimuar.

Vendimi per te emeruar anetaret e GJK pa kaluar vettingun (nje veprim ne kundershtim me kushtetuten) eshte nje tjeter rast ku Basha mundet te djege mandatet edhe te provoje se eshte se paku nje kryetar normal i nje partie politike qe reagon (pra ka reflekse). Por me sa shoh, Basha nuk e mendon kete si veprim.

Cuditerisht, ai cirret duke akuzuar mediat "se nuk lene opoziten te flase" apo i "meson qytetaret se cfare duhet te bejne" dhe harron te flase per aksione reale politike. Mbase kjo heshtje deshmon friken e tij se mos lista Basha konvertohet ne ndonje liste tjeter. Apo ndoshta ai realisht e beson se nje dite do te vije ne pushtet edhe duke u sjelle sic po sillet (mbase Rama e genjen apo ka futur Erionin ta genjeje). Por e verteta e hidhur eshte se demokratet perdite po e shohin me qarte, impotencen opozitare perballe nje keqqeverisje si kjo e Rames.

Cdo te enjte ne kuvend shohim se si beteja e Bashes perballe Rames perfundon me fitoren e te fundit dhe ndonjehere me fitoren e te parit. Rruga e vetme e opozites dhe Bashes eshte te djege mandatet! Rruga e vetme e nje kryetari qe ne 2013 u emerua dhe ne 2017 u ngri per ta shkrire per t'u shnderruar ne "Kryetar opozite" eshte te hedhe ne ere sistemin aktual permes djegies se mandateve. Rruga e vetme e nje opozitari per t'u bere kryeminister eshte te deshmoj qe ka vullnetin per pushtet!



**Jozef Shvejk**

October 10, 2017 ·

Kjo opozita e Lulit nuk i duhet dreqit ama i duhet Rames! Bravo kunat!❤️❤️❤️



**Jozef Shvejk** updated his status.
April 19, 2018 ·

Ç'janë Lulokratët?

Lulokratët janë adhuruesit e aftësive politike, vizionare, organizative, kunatësore, etiko-morale, kurative, kulative, kulinare dhe matematikore të Lulzim Bashës. Bindja e tyre është se Lulzim Basha do të vijë paevitueshmërisht në pushtet në momentin kur yjet ne qiell të rreshtohen në formën e duhur, kur konteksti të jetë i përshtatshëm, kur kushtet të jenë pjekur aq shumë sa fiku të bjerë vetë dhe kur @RealDonaldTrump do të vendosë më në fund të godasë me rrufe dhe me një status në Tweeter Edi Ramën. Ata nuk besojnë tek logjika e votës së lirë dhe bindjes së individit, pasi besojnë thellësisht që Luli është në të drejtën e vet aty ku është, por votuesit janë të korruptuar, të shpifur dhe të shitur aty ku janë.

Sipas lulokratëve, kryetari nuk gabon, nuk do gabojë dhe nuk ka gabuar. Ai është më i pakorruptuari mes të korruptuarve. Me i ndershmi mes të pandershmëve. Më i pastri mes zhulsave. Zgjedhjet e Lulit sipas lulokratëve kanë qenë të sakta ndonëse të imponuara. Përgjithësisht lulokratët janë pesimistë dhe kanë frikë mos dikush tjetër i zë vendin Lulit. Ata mendojnë se vetëm duke rezistuar si kryetar, Luli do të arrijë të mbajë plotësisht përgjegjësi për të gjitha ato që s'ka arritur, por jo për faj të tij, dhe që për faj të të tjerëve nuk do të arrijë ti arrijë dot prapë.

Lulokratët janë pacifistë dhe bezdisen nga kuksianët që bllokojnë rrugët, kamzalinjtë që dalin nëpër mitingje oldschool dhe mamurrsakët që çpojnë gomat.
Lulokratët kanë bezdi nga bërtitjet e highlanderit Berisha, por u tingëllon si muzikë çjerrja e pasardhësit të tij.
Lulokratët janë pro demokracisë, por bezdisen shumë nga togfjalëshi "Demokraci partiake".
Lulokratët përgjithësisht janë për bashkim por këtu nuk e kanë fjalën për bashkimin e partisë.
Lulokratët janë krijesa të periudhës post-berisha, besojnë tek miti i kryetarit te neperkembur dhe gati profetik.
Lulokratët janë për mosbindje civile, me kushtin e vetëm që të mos ketë protesta.
Lulokratët janë gati për sakrifica ekstreme, vetëm e vetëm që të mos kalohet në ekstremizma.
Lulokratët janë në thelb antiberishistë por gjithashtu mbështetës dhe vlerësues të mëdhenj të të madhit dhe të vetmit Sali Berisha.
Lulokratët besojnë realisht se një ditë Luli do rritet dhe do të jetë një Lul kombëtar po aq sa edhe vetë Mona Kombëtare.
Lulokratët ëndërrojnë fshehurazi që një ditë Luli do ngrihet sërish dhe do tua fusë përsëri të gjithëve, madje edhe atyre vetë, më mirë edhe se vetë Edi Rama.

Lulokratët janë burokratët e ardhshëm të Lulit.
Ata janë ushtria e Republikës së Re, që marshon pa iu dridhur qerpiku nën himnin e lavdishëm

"Fuul mi uanc shejm on ju, fuul mi tuajc shejm on mi, fuul mi thrajs, o so najs"

Përpara!



**Jozef Shvejk**

July 20, 2017 · YouTube ·

Xhemali Xhemali.....

WWW.YOUTUBE.COM

**[Humor] Kunati i Shokut Xhemal**



**Jozef Shvejk**

August 24, 2017 ·

Ore ky Luli as hollandisht nuk di, asnje llaf per Hollanden.



**Jozef Shvejk**

July 25, 2017 ·

Edhe John Snow qe ka me shume fansa se Lul Basha e mblodhi keshillin e Winterfell me e pyt ne duhet te takonte Nonen e Dragonjve! ✌😂



Jozef Shvejk
June 28, 2017 ·

Sa me shume kalojne ditet aq me shume edhe alibite e Lulzim Bashes bien perballe argumentave kokforta qe u pane ne zgjedhjet e 25 qershorit. Pasi shesh se si argumentet qe ngrihen ne mengjes bien deri ne fund te dites, Basha perpiqet te prodhoje te tjera argumenta (sic qe edhe ngrirja) si e si qe te mbijetoje ne nje parti ku ai ka futur parate e tij por s'ka mundur te dale dot me fitim.

Situaten e veshtirsoi per nje moment edhe shoku i ngushte i Bashes, i cili ne mitingun e fitores rezervoi disa fjale dashurie per Lulin njesoj sic Meta rezervonte dikur per Berishen. Per ta thene me shqip, Basha nuk di si te reagoje perballe nje elektorati kapricoz qe ka PD-ja. Nje elektorat qe duket se e ka pranuar perdhunen e autoritarizmit vetem tek Berisha por jo tek Basha (e me gjase as tek ndonje tjeter pas tij). Me te gjtihe skemat e shemtuara qe ka ne treg, Lulzim Basha kercen nga nje argument tek nje tjeter per t'i bishtnuar pergjegjesise se tij personale. Ne 2015 nuk foli per humbje por per fitore ndersa ne 2017 nuk flet per humbje por per vetengrirje.

I vene perpara nje pergjegjesie qe ai nuk e perballon, sepse Luli njesoj si nje deputet i ri i PD-se nuk ka bere palester, ka vendosur te shpike nje gare ne kundershtim te plote me statutin e PD-se. Mendoj qe shume shpejt edhe per kete Basha do te kete nje alibi, mund te thote qe eshte hera e fundit qe do ndodhe keshtu se ne Republiken e Re te Partise Demokratike nuk do vendose me kryetari vetengrirje.

Pra, do te kemi gare te vetengrire por jo gare reale. Per te mos lene nam me flete votimi me numer serie duhet angazhuar nje proces me interesant ne votim. Cili eshte ky proces? Evidentimi i emrave armiq dhe sulmi personal. Natyrisht, Partia Demokratike sot ka emra qe mund ta rivalizojne Bashen, shume prej tyre jane milionere edhe te akuzuar per korrupsion. Por, vete z. Basha eshte nje milioner dhe i akuzuar per korrupsion gjithashtu, por kjo s'ka ndonje rendesi.

Ne thelb, kandidatet potencial te Bashes jane te korruptuar po aq sa zoti Basha, jane milioner po aq sa Basha dhe jane ish ministra apo funksionare te PD-se se Berishes po aq sa Basha. Te pretendosh qe Basha eshte mbi keto persona vetem e vetem se ke nje afeksion personal eshte se paku jo parimore dhe se shumti anti demokratike, po cfare rendesie ka ketu?

Ajo qe ndodh sot me PD-ne duket se eshte vazhdimi i alternatives se deshtuar qe para se te lindte, Republikes se Re! Nje nocion qe as gjeti mbeshtetje edhe as do te gjeje mbeshtetje por ka gjasat te jete emri i kongresit te radhes se PD-se ku kjo parti mundet te ndryshoje edhe emer edhe ngjyra. A do ta mbeshtesin kete demokratet? Une per vete dyshoj, Ndonese demokratet nuk kane nje perkufizim fiks se cfare eshte nje i tille, kane nje common sense per te qenurit te tille. Natyrisht Basha mund te krijoje Partine e Bashes per Republiken e Re apo Partia e Republikes se Re apo Partia Demokratike Republika e Re por ajo parti do te mbarti mbi vete vetem bastin personal te nje njeriu qe do te vazhdoje te fitoje gjithnje e me pak mandate. Rama nderkohe do te vazhdoje te ushqeje te semurin e politikes shqiptare nje here me lugen me helm dhe nje here tjeter me melhem duke shtuar dhe ulur dozen sipas interesit.

Mbeshtetesit e PS kurre sdo ankohen pse Rama ushqen kete opozite me melhem apo dhe me mjalte sepse ato e kane kuptuar qe armiku (apo kundershtari) nuk do jete kurre ne gjendjen e tyre. Kete do te sjelle mungesa e gares dhe mos singeriteti ne te!



**Jozef Shvejk**

June 26, 2017 ·

Partia Socialiste ka festuar fitoren, gjithe demokratet jane deshperuar nga humbja. Vetem Lul Basha nuk flet per humbje por sic e donzakoni nxjerr buratinin e radhes, Ervin Salianjin, per te folur dicka qe ai nuk e thote. Ne 2015 ndodhi e njejta situate. Luli nuk di as te fitoje dhe as te humbase, cfare specie e rralle?!